<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Softueri i jashtëm i aplikacionit i përfshirë në Sistemet Fiskale të POS</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>External application software included in Fiscal POS Systems</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Spoljni softver aplikacije uključen u Fiskalni Sistem POS-a</b></p>
<p>1. Softueri i jashtëm i aplikacionit i përfshirë në sistemin fiskal të POS-it, mbështet pjesën tjetër të funksioneve sistimore për menaxhim të të dhënave (kontabiliteti dhe të ngjashme).</p> <p>2. Në rastet ku softueri i aplikacionit është i ndërlidhur me përmbajtjen e faturave fiskale, personi i autorizuar që e bënë instalimin, së bashku me shfrytëzuesin, si dhe personin e autorizuar për softuerin e POS-it të ofrojnë konfirmim me shkrim për ATK-në se softueri funksionon si duhet në pajtueshmëri me specifikacionet dhe kushtet për sigurinë e të dhënave. Testimi, i cili duhet të bëhet para se PEF të vendoset në funksion, duhet të konfirmoj se softueri i cili gjeneron kuponët fiskal operon plotësisht në pajtueshmëri me kërkesat ligjore tatimore për librat dhe regjistrat, me kërkesat e këtij Udhëzimi Administrativ, me specifikacionet teknike dhe funksionale të aprovuara nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së, si dhe që nuk cenon në asnjë mënyrë integritetin e të dhënave fiskale të PEF-it.</p>	<p>1. External application software included in Fiscal POS System supports the rest of the data management system functions (accounting, similar).</p> <p>2. In cases where installed application software is related to the contents of fiscal receipts, the authorised person making the installation, along with the user, must provide written confirmation to the TAK that the software operates properly in accordance with specifications and data security requirements. The testing, which must be made before the FED is put into operation, should attest that the software generating the fiscal receipt fully operates in accordance with the legal tax requirements on bookkeeping and registers, requirements of this Administrative Instruction, technical and functional specifications of the TAK General Director, and does not in any way violate the integrity of the FED fiscal data.</p>	<p>1. Spoljni softver aplikacije uključen u Fiskalni sistem POS-a, podržava drugi deo sistemskih funkcija za upravljanje podacima (računovodstvo i slično).</p> <p>2. U slučajevima kada je softver aplikacije povezan sa sadržajem fiskalnih računa, ovlašćeno lice koji obavlja instaliranje, zajedno sa korisnikom, kao i ovlašćenim licem za softver POS-a da pruže pismenu potvrdu za PAK da softver funkcioniše prikladno u skladu sa specifikacijama i uslovima o bezbednosti podataka. Testiranje, koje treba da se obavlja pre nego se FEO postavi u funkciji, treba da potvrdi da softver koji generiše fiskalne kupone radi u potpunosti sa pravnim poreskim zahtevima o knjigama i registrima, sa zahtevima ovog Administrativnog Uputstva, tehničkim i funkcionalnim specifikacijama odobrenih od Generalnog Direktora PAK-a, kao i da ne ugrožava na bilo koji način integritet fiskalnih podataka FEO.</p>

<p>3. Testimi që konfirmon me shkrim funksionimin normal të softuerit, përfshin:</p> <p>3.1. Detajet e plota mbi prodhuesin e softuerit të aplikacionit;</p> <p>3.2. Emrin e saktë të shpërndarjes dhe numrin e versionit aktual të softuerit;</p> <p>3.3. Një kopje të versionit demonstrues të softuerit specifik të ruajtur në një format dhe medium përkatës;</p> <p>3.4. Të dhënat e plota mbi kërkesat e softuerit dhe kushtet operuese në kompjuter;</p> <p>3.5. Funksionimi i PEF-it me një sistem të ndërlidhur që shfrytëzon softuerin e pa autorizuar të aplikacionit për lëshimin e kuponit fiskal është i ndaluar dhe i nënshtrohet ndëshkimeve siç parashikohet në legjislacionin përkatës;</p> <p>3.6. Për specifikacionet funksionale dhe teknike të softuerëve në rastet e veçanta, nxirret vendim nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së.</p>	<p>3. The testing which confirms normal functioning of the software in writing includes:</p> <p>3.1. Full details on the manufacturer of the application software;</p> <p>3.2. The exact distribution name and the current version number of this software;</p> <p>3.3. A copy of a demo version of the specific software, saved in an appropriate medium format;</p> <p>3.4. Full data on the software's requirements and operating conditions in a computer;</p> <p>3.5. The operation of a FED with an interconnected system using unauthorised application software for issuing a fiscal receipts is strictly forbidden and is subject to penalties as foreseen by respective legislation;</p> <p>3.6. In special cases, for functional and technical specifications of the software shall be issued by the TAK General Director.</p>	<p>3. Testiranje koje potvrđuje pismeno normalno funkcionisanje softvera, uključuje:</p> <p>3.1. Potpune detalje o proizvođaču softvera aplikacije;</p> <p>3.2. Tačan naziv raspodele i broj sadašnje verzije softvera;</p> <p>3.3. Jednu kopiju verzije za prikazivanje specifičnog softvera sačuvan u prikladnom formatu i medijumu;</p> <p>3.4. Potpuni podaci o zahtevima softvera i uslovi upotrebe u kompjuter;</p> <p>3.5. Funkcionisanje FEO sa jednim povezanim sistemom koji koristi neovlašćeni softver aplikacije za izdavanje fiskalnog kupona je zabranjen i podvrgava se kažnjavanju kao što se predviđa dotičnim zakonodavstvom;</p> <p>3.6. Za funkcionalne i tehničke specifikacije softvera u posebnim uslovima, usvaja se odluka od Generalnog Direktora PAK-a.</p>
---	---	---

<p align="center"><b>Neni 10</b> <b>Rrjeti i Komunikimit</b></p>	<p align="center"><b>Article 10</b> <b>Communication network</b></p>	<p align="center"><b>Član 10</b> <b>Mreža Komuniciranja</b></p>
<p>1. Për transmetimin elektronik të të dhënave fiskale në intervalet e paracaktuara krijohet rrjeti i komunikimit ndërmjet PEF-it dhe ATK-së nëpërmes KMS dhe TT.</p> <p>2. Serveri i ATK-së mundet në çdo kohë të vendos komunikimin (on demand) me KMS-in e PEF-it dhe kërkon:</p> <p>2.1.Raport ditorë;</p> <p>2.2.Totali i kuponëve fiskal; dhe</p> <p>2.3. Informata të tjera të kërkuara nga ATK.</p> <p>3. Rrjetet e të dhënave fiskale të komunikimit ndërmjet PEF-it dhe ATK-së, duhet të jenë:</p> <p>3.1 Të sigurta – Të gjitha lidhjet duhet të operojnë në Rrjete Virtuale Private (VPN), ndërmjet TT dhe sistemit kompjuterik të ATK-së, të lidhura përmes internetit. Ofruesit e telekomunikimit janë përgjegjës për zbatimin dhe mirëmbajtjen e topologjisë dhe operimit të VPN-së përmes teknologjisë GPRS. Ata e mbështesin çdo TT me SIM kartelë dhe me një adresë dinamike. TT-ja</p>	<p>1. A communication network shall be established between FED and the TAK for the purpose of electronically transmitting fiscal data on a predetermined interval through SCM and TT.</p> <p>2. TAK Server can at any time establish communication (on demad) with SCM of FED and request the following:</p> <p>2.1.Daily report;</p> <p>2.2.Total number of fiskalni receipts; and</p> <p>2.3. Other information as requested by TAK.</p> <p>3. Fiscal data communications networks between FED and the TAK must be:</p> <p>3.1. Secure - All connections must operate on a Virtual Private Network (VPN), between the TT and TAK computer system, connected to internet. Telecommunication providers are responsible for implementation and maintenance of VPN topology and operation through GPRS technology. They support each TT with SIM card</p>	<p>1. Za elektronski prenos fiskalnih podataka u prethodno određenim intervalima od strane PAK-a stvara se mreža komuniciranja između PAK-a i FEO preko SKM i PT.</p> <p>2. Server PAK-a može u bilo koje vreme (on demad) da uspostavi komunikaciju sa SKM FEU-a i potrazi :</p> <p>2.1.Presek stanja;</p> <p>2.2.Totali fiskalni bonova; i</p> <p>2.3. I ostale informacije po zahtevu PAK-a.</p> <p>3. Mreže fiskalnih podataka komuniciranja između FEO i PAK, treba da budu:</p> <p>3.1 Bezbedne – Sve vrste povezivanja koje deluju u Virtualnim Privatnim Mrežama (VPN), između PT i kompjuterskog sistema PAK-a, povezane kroz internet. Provajderi telekomunikacije su odgovorni za primenu i održavanje topologije i delovanja VPM-a kroz GPRS tehnologiju. One podržavaju svaku PT sa SIM karticama i dinamičkom adresom.</p>

<p>duhet të jetë i konfiguruar që të punojë vetëm me një PEF;</p> <p>3.2 PEF komunikon me serverin e ATK-se brenda nje orari ne kohën e caktuar nga ana e serverit të ATK-së përmes Kripto Modulit të Sigurtë. Gjithëashtu serveri i ATK-së mundet në çdo kohë të vendos komunikimin me krypto modulën e sigurt të PEF-it;</p> <p>3.3 Efikase – Nuk lejohet trafik apo rrugëtim i panevojshëm nëse nuk është përcaktuar nga serveri i ATK-se. Trafiku i rrjetit duhet të caktohet në atë mënyrë që do të zvogëlojë shpenzimet për ATK-në dhe tatimpaguesin, duke përmbushur njëkohësisht të gjitha kërkesat e specifikuar;</p> <p>3.4 Kompatibile – PEF dhe pajisjet transmetuese duhet të jenë në pajtueshmëri me të gjitha protokollet dhe standardet e komunikimit. Komunikimi me serverin e ATK-së përmes TCP/IP socket sipas specifikave teknike dhe funksionale të kërkuara nga ATK-ja.</p> <p>4. Ofruesit e telekomunikimit duhet të jenë të autorizuar nga ATK-ja që të ofrojnë shërbime për bartjen e të dhënave fiskale nga PEF në sistemin e ATK-së, sipas kërkesave funksionale dhe teknike të përcaktuara nga ATK-ja.</p>	<p>through dynamic address. The TT must to be configured to work only with one FED;</p> <p>3.2. FED will communicate with TAK server as per set schedule and set time by the TAK server through secure crypto modul. TAK server can at any given time establish communication with FED's secure crypto module;</p> <p>3.3. Efficient - No unnecessary routing of traffic is permitted unless determined by TAK server. Network traffic must be routed in a manner that minimizes cost to taxpayers while meeting all specified requirements;</p> <p>3.4. Compatible - FED and transmitting equipment must be in compliance with all communication protocols and standards. Communication with TAK server is established via TCP/IP socket as per requested technical specifications from TAK.</p> <p>4. Telecommunication providers must be authorised by TAK to provide services for transmitting fiscal data by FED into TAK system, according to the functional and technical requirements specified by TAK.</p>	<p>PT treba da bude konfigurisan da radi samo sa jednim FEO;</p> <p>3.2. FEU komunicira sa PAK serverom po zadatom rasporedu u zadatom vremenu od strane PAK server-a preko sigurnog krypto modula. Server PAK-a može u bilo koje vreme da uspostavi komunikaciju sa sigurnim krypto modulom FEU-a</p> <p>3.3. Efikasno – Ne dozvoljava se nepotrebno putovanje ukoliko nije određeno od server PAK-a. Prenos mreže treba da se odredi na način koji će smanjiti troškove po PAK i poreskog obveznika, ispunjavajući u isto vreme sve naznačene zahteve;</p> <p>3.4. Kompatibilno – FEO i oprema za prenos treba da budu u skladu sa svim protokolima i standardima komuniciranja. Komunikacija sa PAK serverom je TCP/IP sockets prema funkcionalnih i tehničkih zahteva određenih od PAK-a .</p> <p>4. Provajderi telekomunikacije treba da budu ovlašćeni od PAK-a za pružanje usluga prenosa fiskalnih podataka sa FEO na sistem PAK-a, prema funkcionalnih i tehničkih zahteva određenih od PAK-a.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Sistemi informativ i integruar në ATK</b></p> <p>1. Sistemi i teknologjisë informative në ATK duhet të pranojë të dhënat fiskale të kriptuara (të shifruara) dhe të dhënat tjera të transmetuara nga të gjithë tatimpaguesve të lidhur me sistemin e ATK-së.</p> <p>2. Sistemi i TI-së, informatat në një fajll të veçantë elektronik do t'i procesojë në mënyrë automatike për secilin tatimpagues.</p> <p>3. Shpeshtësia e transmetimit të të dhënave do të përcaktohet në një vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>Information System integrated into TAK</b></p> <p>1. TAK Information Technology system must receive the fiscal encrypted data and other data of all taxpayers connected to TAK system.</p> <p>2. The IT system will automatically process information into a special electronic file for each taxpayer.</p> <p>3. The frequency of transmitting the data shall be determined by a decision issued by the TAK General Director.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Integrirani Informativni Sistem PAK</b></p> <p>1. Sistem informativne tehnologije u PAK treba da primi fiskalne kriptirane (šifovane) podatke i ostale prenete podatke svih poreskih obveznika povezani sa sistemom PAK-a.</p> <p>2. IT Sistem, informacije u jednom posebnom elektronskom fajlu će procesirati na automatski način za svakog poreskog obveznika.</p> <p>3. Učestalost prenosa podataka će se odrediti odlukom Generalnog Direktora PAK-a.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b> <b>Njësia për Menaxhimin e Arkave Fiskale</b></p> <p>1. Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së do të themelojë Njësinë për Menaxhimin e Arkave dhe Sistemeve Fiskale (NjMAF) e cila ka për detyrë:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1 Zhvillimin dhe zbatimin e procedurave të testimit dhe miratimit të PEF-ve dhe pajisjeve të tjera, duke përfshirë të gjitha modelet dhe llojet e PEF-ve që do të</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 12</b> <b>Fiscal Cash Register Management Unit</b></p> <p>1. TAK Director General shall establish Fiscal Cash Register and Systems Management Unit (FCRMU) which is responsible for:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1 Developing and implementing procedures for testing and approving FEDs and other equipment, including all FED models and types to be authorised</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 12</b> <b>Jedinica za Upravljanje Fiskalnih Blagajni</b></p> <p>1. Generalni Direktor PAK-a će osnovati Jedinicu za Upravljanje Blagajni i Fiskalnih Sistema (JUFB) koja ima sledeće zadatke:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1 Razvoj i primenu procedura testiranja i odobravanja FEO i ostale opreme, uključujući sve modele i vrste FEO koja će se ovlastiti za upotrebu u Republici</p>

<p>autorizohen për shfrytëzim në Republikën e Kosovës, bazuar në shqyrtimin e specifikacioneve të prodhuesit për të përcaktuar nëse i plotësojnë kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara për PEF;</p> <p>1.2 Shqyrtimin e kërkesave të operatorëve të mundshëm ekonomik për shitje, instalim dhe mirëmbajtje të PEF-ve, për t'u siguruar që i plotësojnë kriteret e përcaktuara nga NjMAF;</p> <p>1.3 Testimin e modeleve të propozuara të PEF-ve, për t'u siguruar që i plotësojnë specifikacionet teknike dhe funksionale; si dhe CE standardet internacionale;</p> <p>1.4 Përcaktimin e rregullave në implementimin e obligimeve të sigurisë dhe mënyrave për mbikëqyrjen e teknikëve në lidhje me instalimin dhe riparimin e PEF-ve;</p> <p>1.5 Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së mund t'i caktojë Njësisë çdo funksion tjetër që ai e konsideron të nevojshëm për funksionimin e drejtë të sistemit të PEF-ve.</p> <p>2. Zhvillimin e procedurave për aplikim, autorizim për të shitur, instaluar dhe riparuar PEF, si dhe procedurat e brendshme dhe</p>	<p>for use in the Republic of Kosovo, based on review of the manufacturer's specifications to determine if they meet the technical and functional requirements defined for FED;</p> <p>1.2 Reviewing applications of potential economic operators for sales, installation and maintenance of FEDs, to secure that they meet the criteria set by FCRMU;</p> <p>1.3 Testing proposed FED models, to secure that they meet the technical and functional specifications and international CE standards;</p> <p>1.4 Determining the rules on the implementation of security obligations and means of supervising technicians when it comes to FED installation and repair;</p> <p>1.5 The TAK Director General may assign any other function to the Unit as he considers necessary for proper functioning of the FED system.</p> <p>2. Developing procedures for application, authorisation to sell, install and repair FEDs, as well as internal procedures and</p>	<p>Kosovo, na osnovu razmatranja specifikacija proizvođača radi utvrđivanja da li ispunjavaju tehničke i funkcionalne zahteve određenih za FEO;</p> <p>1.2 Razmatranje zahteva mogućih ekonomskih operatera za prodaju, instaliranje i održavanje FEO, radi osiguranja da ispunjavaju kriterije određenih JUFB;</p> <p>1.3 Testiranje predloženih modela FEO, radi osiguranja da ispunjavaju tehničke , funkcionalne zahteve i međunarodne CE standarde ;</p> <p>1.4 Određivanje pravila za sprovođenje obaveza sigurnosti i načina za nadzor tehničara u vezi sa instaliranjem i popravkom FEO;</p> <p>1.5 Generalni Direktor PAK-a može da odredi Jedinici svaku drugu funkciju koju on smatra potrebnim za pravilno funkcionisanje FEO.</p> <p>2. Razvoj procedura za apliciranje, instaliranje i popravku FEO, kao i unutrašnje procedure i funkcionisanje ove</p>
---	---	--



<p>funksionimin e kësaj Njësie do të përcaktohen me Përshkrimin e Detyrave të Punës si dhe në bazë të dokumenteve strategjike të ATK-së.</p>	<p>functioning of this Unit shall be determined by their job descriptions and based on TAK strategic documents.</p>	<p>Jedinice će se odrediti Opisom Radnih Zadataka kao i na osnovu strateških dokumenata PAK-a.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b> <b>Autorizimet për Operatorët e Licencuar</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 13</b> <b>Authorisations for Licensed Operators</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 13</b> <b>Ovlašćenja za Licencirane Operatore</b></p>
<p>1. Operatorët e Licencuar sipas dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr. 1/2015, konsiderohen të jenë të autorizuar për zhvillimin e procesit të fiskalizimit të tatimpaguesve me PEF, deri në përmbylljen e periudhës kalimtare, apo deri me një vendim tjetër nga ATK.</p>	<p>1. The Operators licensed under the provisions of Administrative Instruction no 1/2015 are deemed to be authorised to develop taxpayer's fiscalisation process with FED until the end of the transitional period, or until another decision by TAK.</p>	<p>1. Licencirani Operatori od dotične Komisije prema odredbama Administrativnog Uputstva Br. 1/2015, smatraju se da su ovlašćeni za razvoj procesa fiskalizacije poreskih obveznika sa FEO, do kraja prelaznog perioda, ili do druge odluke PAK-a.</p>
<p>2. Operatori Ekonomik obligohet të përkrahë me pjesë rezervë dhe mirëmbajë PEF të cilat janë në shfrytëzim nga tatimpaguesit për të paktën pesë (5) vite nga data e fundit e shitjes së PEF-it në tregun e Kosovës.</p>	<p>2. The Economic Operator is obliged to support the spare parts and maintain PEFs that are in use by the taxpayer for at least five (5) years from the last date of FED's sale to the Kosovo market.</p>	<p>2. Ekonomski operater je obavezan da podrži rezervne delove i održava PEF-ove koje poreski obveznik koristi u periodu od najmanje pet (5) godina od poslednjeg datuma prodaje FED-a na tržište Kosova.</p>
<p>3. Në qoftë se një model i PEF nuk ricertifikohet nga OE për çfarëdo arsye, atëherë ky model nuk ka të drejtë të shitet nga OE dhe nga Tatimpaguesi si Pajisje Elektronike Fiskale.</p>	<p>3. If a PEF model is not re-certified by EO for any reason, then this model is not eligible to be sold by EO and Taxpayer as Fiscal Electronic Appliances.</p>	<p>3. Ako FEO model ne preusmeri EO iz bilo kog razloga, onda ovaj model nije podoban za prodaju od strane EO i poreskog obveznika kao fiskalnih elektronskih uređaja.</p>
<p>4. Pajisja Elektronike Fiskale e cila për 5 vite është përdorur nga i njëjti tatimpagues, dhe e cila më tutje nuk përkrahët me pjesë reserve dhe mbështetje nga Operatori Ekonomik, nuk mund të përdoret si PEF.</p>	<p>4. The Fiscal Electronic Device that has been used by the same taxpayer for 5 years and which is not supported by reserve parts and support by the Economic Operator can not be used as FED.</p>	<p>4. Fiskalni elektronski uređaj koji je isti poreski obveznik koristio 5 godina i koji nije podržan rezervnim delovima i podrškom od strane ekonomskog operatera ne može se koristiti kao FEO.</p>

5. Përjashtim nga paragrafi 4 i këtij neni, Pajisja Elektronike Fiskale e cila edhe pas 5 viteve të përdorimit, i përmbush kërkesat teknike dhe funksionale si dhe përkrahet nga Operatori Ekonomik, mund të përdoret si PEF.

**Neni 14**  
**Aplikimi për Operator dhe Pajisje**

1. Çdo prodhues, importues ose montues i PEF, mund të bëhet Operator i autorizuar i PEF, për një apo më shumë modele specifike në çdo kohë sipas kritereve të publikuara nga Njësia për Menaxhimin e Arkave Fiskale (NjMAF).

2. Kërkesa për të qenë operator i autorizuar, dorëzohet në çdo kohë, mirëpo shitja e pajisjeve fiskale mund të bëhet vetëm pas aprovimit nga NjMAF.

3. Certifikimi i PEF-ve bëhet nga Institutet, Labororët apo Institucionet kompetente dhe të autorizuar për testimin dhe verifikimin e përmbushjes së kërkesave teknike dhe funksionale të përcaktuara me kërkesa të veçanta.

4. Autorizimi i Instituteve, Labororëve apo Institucioneve kompetente bëhet në bazë të

5. Except as provided in paragraph 4 of this Article, the Electronic Fiscal Device, which even after 5 years of use meets the technical and functional requirements and is supported by the Economic Operator, may be used as FED.

**Article 14**  
**Applications for Operator and Equipment**

1. Any FED manufacturer, importer or assembler may become FED authorised operator, for one or more specific models at any time according to the criteria published by the Fiscal Cash Management Register Unit (FCRMU).

2. An application to become authorised operator is submitted at any time, but the sale of fiscal devices can be made only after the approval by FCRMU.

3. Certification of FED shall be made by institutes, laboratories or institutions competent and authorised for testing and verification of compliance with technical and functional requirements laid down by special requirements.

4. Authorization of Institutes, Laboratories or competent institutions shall be made

5. Osim što je predviđeno u stavu 4 ovog člana, Elektronski fiskalni uređaj, koji čak i nakon 5 godina upotrebe zadovoljava tehničke i funkcionalne zahtjeve koji je podržan od strane ekonomskog operatera, može se koristiti kao FEO

**Član 14**  
**Apliciranje za Operatora i Opremu**

1. Svaki proizvođač, ili monter FEO, može da postane ovlašćeni Operator za FEO, za jedan ili više specifičnih modela u bilo koje vreme prema kriterijumima objavljenih od Jedinice za Upravljanje Fiskalnih Blagajni (JUFB).

2. Zahtev da se postane ovlašćeni operator, dostavlja se blagovremeno, ali prodaja fiskalne opreme može da uradi samo nakon odobranja od JUFB.

3. Certifikacija FEO se obavlja od Institucija, Laboratorija ili nadležnih i ovlašćenih Institucija za testiranje i overavanje tehničkih i funkcionalnih zahteva koje su određene posebnim zahtevima.

4. Ovlašćenje Institucija, Laboratorija ili kompetentnih Institucija se obavlja na

<p>kritereve të përcaktuara nga NjMAF.</p> <p>5. Instalimi dhe mirëmbajtja e PEF-ve, bëhet vetëm nga personeli i operatorit të autorizuar, që ka shitur PEF-ët.</p> <p>6. NjMAF është përgjegjës të kërkojë dhe të verifikoj çdo informatë dhe të dhënë, duke përfshirë: dëshminë e përvojës, solvencën, kredibilitetin, personelin teknik dhe të dhëna të ngjashme.</p> <p>7. NjMAF brenda 60 ditësh nga data e pranimit të kërkesave dhe informatave vendos për dhënien apo jo të autorizimit për operatorin ekonomik.</p> <p>8. NjMAF është përgjegjës të tërheqë dhe anulojë autorizimin e dhënë në rast se:</p> <p>8.1 Përdoruesit ballafaqohen me probleme serioze;</p> <p>8.2 Operatori ekonomik e ka shkelur ndonjë dispozitë të këtij apo ndonjë akti tjetër nënligjor të lëshuar lidhur me PEF-ët;</p> <p>8.3 Operatori ekonomik nuk dorëzon deklaratat tatimore ose nuk kryen në kohë obligimet tatimore;</p>	<p>according to criteria set by FCRMU.</p> <p>5. Installation and maintenance of the FED shall be made only by authorized personnel of operator selling FEDs.</p> <p>6. FCRMU shall be responsible to seek and verify all information and data, including proven experience, solvency, credibility, technical personnel and similar data.</p> <p>7. FCRMU within 60 days from the date of receiving applications and information decides to grant an authorisation or not to the economic operator.</p> <p>8. FCRMU shall be responsible to withdraw and cancel the authorisation granted if:</p> <p>8.1. users are facing serious problems;</p> <p>8.2. The economic operator violated any provision of this or any other sub-legal act issued for FEDs;</p> <p>8.3. The economic operator does not submit tax declarations or does not timely settle tax obligations;</p>	<p>osnovu kriterija određenih od JUFB.</p> <p>5. Instaliranje i održavanje FEO, se obavlja samo od osoblja ovlašćenog operatora, koji je prodao FEO.</p> <p>6. JUFB je odgovoran da zahteva i da overi svaku informaciju i podatak, uključujući: dokaz o iskustvu, solventnost, kredibilnost, tehničko osoblje i slični podaci.</p> <p>7. JUFB unutar 60 dana od datuma prijema zahteva i informacija odlučuje za davanje ili ne ovlašćenja za ekonomskog operatera.</p> <p>8. JUFB je odgovoran da povlači i anulira dato ovlašćenje u slučaju da:</p> <p>8.1. Korisnici se suočavaju ozbiljnim problemima;</p> <p>8.2. Ekonomski operator je prekršio neku odredbu ovog ili nekog drugog podzakonskog akta koji je usvojen vezano sa FEO;</p> <p>8.3. Ekonomski operator ne dostavlja poreske deklaracije ili ne obavlja na vreme ili ne izvršava na vreme poreske</p>
--	---	--

<p>8.4 Në rast të ndryshimit të kushteve sipas të cilave është dhënë autorizimi.</p> <p>9. Kundër vendimit të NJMAF-së mund të ushtrohet ankesë në gjykatën kompetente. Gjykata mund të kërkojë ndonjë mendim këshillues duke u bazuar në shqyrtimin e fakteve dhe njohurive për pajisjet elektronike fiskale nga një ekspert i pavarur i TI-së.</p> <p>10. Testet e kohëpaskohshme, sipas kërkesësë, nëpërmjet kontrollit për operim të duhur të pajisjeve mund të bëhen nga NjMAF, ose nga institucionet, laboratorët apo organizatat e caktuara të autorizuar prej kësaj Njësie, për t’u siguruar që pas aprovimit fillestar pajisjet elektronike fiskale dhe sistemet vazhdojnë të përmbushin kërkesat përkatëse dhe të veprojnë me besueshmëri edhe pas instalimit në pika të shitjes.</p> <p>11. ATK-ja ka të drejtën e rishikimit të çdo instalimi të PEF-ve të bërë nga çdo operator, për t’u siguruar se ajo punon në përputhje me kërkesat dhe specifikacionet e vendosura. Përveç kësaj, ATK-ja ka të drejtën të rishikojë regjistrimet e çdo operatori për t’u siguruar se ai i përmbush të gjitha kërkesat e vendosura në lidhje me autorizimin e tyre për të vepruar si shitës i PEF-ve.</p>	<p>8.4. conditions under which the authorisation is granted are changed.</p> <p>9. An appeal against FCRMU’s decision is filed in the competent court. The court may request an advisory opinion based on the review of the facts and expertise in fiscal electronic devices from an independent IT expert.</p> <p>10. The occasional tests, upon request, through checks for proper operation of the equipment can be carried out by FCRMU or institutions, laboratories, or other organisations authorised by this unit, to ensure that after the initial approval, fiscal electronic devices and systems continue to comply relevant requirements and operate reliably even after installation in point of sale.</p> <p>11. TAK shall be entitled to review any FED installation made by any operator to ensure that it works in accordance with the set forth requirements and specifications. In addition, TAK shall be entitled to review records of each operator to ensure that it meets all the requirements set regarding their authorisation to act as a FED vendor.</p>	<p>obaveze;</p> <p>8.4. U slučaju izmene uslova prema kojima je dato ovlašćenje.</p> <p>9. Protiv odluke JUFB može da se podnese žalba u nadležnom sudu. Sud može da zahteva neko savetodavno mišljenje na osnovu razmatranja činjenica i znanja o fiskalnoj elektronskoj opremi od nekog nezavisnog stručnjaka za IT.</p> <p>10. Povremeni testovi, na osnovu zahteva, kroz kontrolu za prikladno operisanje opreme može da se uradi od JUFB, ili institucija, laboratorija ili određenih organizacija ovlašćenih od ove Jedinice, radi osiguranja da nakon početnog odobravanja elektronska fiskalna oprema i sistem nastavlja da ispunjavaju odgovarajuće zahteve i da deluju verodostojno i nakon instaliranja u prodajnim mesta.</p> <p>11. PAK ima pravo pregleda svake instalacije FEO od svakog operatora, radi obezbeđenja da rade u skladu sa uspostavljenim zahtevima i specifikacijama. Osim toga, PAK ima pravo pregleda registriranja svakog operatora radi obezbeđenja da ispunjava sve uspostavljene zahteve u vezi sa njihovim ovlašćenjem da deluje kao prodavac FEO.</p>
--	---	---

<p>12. ATK-ja me aprovimin e Ministrit nxjerr akt nënligjor që përshkruan procedurat që duhet të ndiqen dhe dokumentet që duhet të dorëzohen kur të kërkohet autorizimi për të shitur dhe instaluar PEF-të. Në akt nënligjor, përveç kërkesave tjera që NjMAF mund t'i vendosë, duhet të kërkohet që:</p> <p>12.1 Operatori të garantojë punën me një garanci bankare, apo forma tjera të garantimit të pranueshëm. Operatori duhet të ofrojë dëmshpërblim, në rast se pajisja e shitur dhe e instaluar është gjetur se nuk plotëson specifikacionet teknike dhe funksionale, të përcaktuara në aktet në fuqi në kohën e instalimit;</p> <p>12.2 Për çdo mosrespektim të kushteve të parashtruara nga NjMAF gjatë kryerjes së aktiviteteve të veta në shitjen, instalimin dhe riparimin e PEF-ve, operatorët ekonomik do të jenë përgjegjës direkt dhe do t'i nënshtrohen përgjegjësiive ligjore të parapara me legjislacionin e aplikueshëm;</p> <p>12.3 Për nevoja të kontrollit nga ATK-ja, operatori përgatit një manual përdorimi për qasjen dhe nxjerrjen e informatave nga PEF;</p>	<p>12. TAK, under the approval of the Minister shall issue a sub-legal act describing the procedures to be followed and documents to be submitted when requesting authorisation to sell and install FEDs. In sub-legal acts, besides other requirements that FCRMU may decide upon, it shall require that:</p> <p>12.1. The operator guarantees its performance through a bank guarantee or other acceptable forms of guarantee. The operator must provide an indemnity for purchasers in the event that the equipment sold and installed is found to not meet the technical and functional specifications determined by acts in force at the time of installation;</p> <p>12.2. For any breach of the conditions set forth by FCRMU when carrying out its activities of sale, installation and repair of the FED, economic operators shall be directly responsible and be subject to legal responsibilities foreseen by applicable legislation;</p> <p>12.3. The operator, for TAK audit needs, shall prepare a user guide on access and retrieval of information from the FED;</p>	<p>12. PAK uz odobrenje Ministra donosi podzakonski akt koji opisuje procedure koje treba da se prate i dokumenta koji treba da se dostave kada se zahteva ovlašćenje za prodaju i instaliranje FEO. Jedan podzakonski akt, osim ostalih zahteva da JUFB može da postavi, treba da zahteva da:</p> <p>12.1. Operator garantuje rad bankarskom garancijom, ili drugim oblikom prihvatljivog garantiranja. Operator treba da pruži obeštećenje, u slučaju da prodata ili instalirana oprema je utvrđeno da ne ispunjava tehničke i funkcionalne specifikacije, određenih odredbama na snazi u vremenu instaliranja;</p> <p>12.2 Za svako nepoštovanje uslova predviđenih sa JUFB tokom izvršavanja svojih aktivnosti tokom prodaje, instaliranja i popravke FEO, ekonomski operatori će biti direktno odgovorni i podvrgavaće se pravnoj odgovornosti predviđena zakonodavstvom na snazi;</p> <p>12.3 Za kontrolne potrebe PAK-a, operator priprema jedan priručnik za pristup i i vađenje informacija sa FEO;</p>
--	--	--

<p>12.4 Operatori, duhet të sigurojë se telekomunikimi, ndërmjet pajisjes dhe sistemit informativ të ATK-së realizohet nëpërmjet një operatori të telekomunikimit të autorizuar nga ATK-ja;</p> <p>12.5 Operatori ekonomik i autorizuar lidhë marrëveshje me operatorin e autorizuar për telekomunikim e cila përmban, ndër të tjera, garancinë e duhur për mundësi të vazhdueshme telekomunikimi ndërmjet pajisjes së instaluar dhe sistemit informativ në ATK, në rast se kompania e telekomunikimit pushon operimet e veta apo vendos të mos vazhdojë të ofrojë shërbime;</p> <p>12.6 Marrëveshja e operatorit të autorizuar me kompaninë telekomunikuese të autorizuar, duhet të parashikojë zëvendësimin apo riparimin e garantuar të pajisjeve të veta të komunikimit (modem dhe pajisje të ngjashme), brenda 48 orëve, pasi të jetë raportuar problemi;</p> <p>12.7 Marrëveshja e operatorit të autorizuar me operatorin telekomunikues të autorizuar, parasheh dëmshpërblimin dhe zëvendësimin në rast se pajisja komunikuese është konstatuar se nuk i plotëson specifikacionet</p>	<p>12.4. The operator must ensure that telecommunications between the device and TAK Information System is executed through a telecommunication operator authorised by TAK;</p> <p>12.5 The authorised economic operator enters into agreement with an authorised telecommunication provider which, inter alia, contains adequate guarantee for continued telecommunications capability between the device installed and Information System in TAK in the event the telecommunications company ceases its operations or decides to terminate offering the service;</p> <p>12.6 The authorised operator's agreement with the authorised telecommunications company provide for guaranteed replacement or repair of its communication device (modem and similar devices) within 48 hours after a problem with the device has been reported;</p> <p>12.7 The authorised operator's agreement with the authorised telecommunications provider foresees indemnity and substitution in the event that the communication device is found</p>	<p>12.4 Operator, treba da obezbedi da telekomunikacija, između opreme i informativnog sistema PAK-a se realizuje pomoću jednog operatora telekomunikacije ovlašćenog od PAK;</p> <p>12.5 Ovlašćeni ekonomski operator sklapa sporazum sa ovlašćenim operatorom iza telekomunikaciju koja sadrži, između ostalog, prikladnu garanciju za kontinuiranu mogućnost telekomunikacije kroz instaliranu opremu i informativnog sistema PAK-a, u slučaju da kompanija telekomunikacije prestaje sa svojim aktivnostima ili odluči da ne nastavi sa pružanjem usluga;</p> <p>12.6 Sporazum ovlašćenog operatora sa ovlašćenom kompanijom za telekomunikacijom, treba da predviđa zamenu ili garantovanu popravku svoje opreme komuniciranja (modem i slične opreme), unutar 48 časova, nakon što je problem izveštavan;</p> <p>12.7 Sporazum ovlašćenog operatora sa ovlašćenim operatorom telekomunikacije, predviđa obeštećenje i zamenu u slučaju da je utvrđeno oprema ne ispunjava tehničke i funkcionalne specifikacije, u</p>
--	---	--

<p>teknike dhe funksionale në kohën kur është instaluar pajisja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b> <b>Lëshimi i numrit unik të autorizimit</b></p> <p>Pas kalimit me sukses të të gjitha testeve për modelin specifik të pajisjes, NjMAF i jep operatorit një numër unik të mbrojtur të autorizimit. Ky autorizim, është dëshmi për blerësit se ai operator është i autorizuar për të shitur atë pajisje dhe se i plotëson të gjitha specifikimet dhe kushtet për shfrytëzim si PEF. NjMAF në bazë të rezultateve në testim duhet të nxjerrë vendim për certifikim të pajisjeve përkatëse brenda 15 ditësh pas aplikimit të operatorit të autorizuar për certifikim të pajisjes përkatëse.</p>	<p>to not meet the technical and functional specifications at the time the device was installed.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 15</b> <b>Issuance of unique authorisation number</b></p> <p>Once a FED model has successfully passed all tests, the FCRMU shall issue and give to the operator a special protected authorisation unique number. This authorisation shall serve as evidence to customers that the operator is authorised to sell that model and that it meets all specifications and terms for use as a FED. FCRMU based on test results must issue a decision on the certification of respective devices within 15 days after the authorised operator applies for certification of the related device.</p>	<p>vremenu kada je instalirana oprema;</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 15</b> <b>Izdavanje jedinstvenog broja ovlašćenja</b></p> <p>Nakon uspešnog polaganja svih testova za specifični model opreme, JUFb daje operatoru zaštićeni jedinstveni broj ovlašćenja. Ovo ovlašćenje je dokaz za kupce da taj operator je ovlašćen za prodaju te opreme i da ispunjava sve specifikacije i uslove za korišćenje kao jedan FEO. JUFb na osnovu rezultata sa testiranja treba da donosi jednu odluku o certifikaciji dotične opreme unutar 15 dana nakon apliciranja ovlašćenog operatora za certifikaciju dotične opreme.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 16</b> <b>Mirëmbajtja e të dhënave lidhur me operatorët e autorizuar, PEF-ët e instaluar dhe shfrytëzuesit</b></p> <p>1. ATK-ja mban evidencë elektronike të të dhënave, për të gjithë PEF-ët e instaluar, në të cilin përfshihen:</p> <p>1.1 identifikimi i pajisjes së instaluar, lloji i pajisjes PEF, numri serik i PEF-it, numri</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 16</b> <b>Maintenance of Data regarding Authorised Operator, installed FEDs and Users</b></p> <p>1. An electronic inventory shall be kept by TAK for all installed FEDs which include:</p> <p>1.1 identification of the device installed – type of FED device, FED serial</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 16</b> <b>Održavanje podataka u vezi sa ovlašćenim operatorima, instalirane FEO i korisnike</b></p> <p>1. PAK održava elektronsku evidenciju podataka, za sve instalirane FEO, na kojima se uključuju:</p> <p>1.1 Identifikacija instalirane opreme, vrstu opreme FEO, serijski broj FEO,</p>

<p>serik i memorjes fiskale, numri serik i KK, prodhuesi dhe modeli i PEF dhe të dhënat tjera të përshkruara në specifikat teknike;</p> <p>1.2 data kur është instaluar pajisja dhe kur është aprovuar nga ATK-ja;</p> <p>1.3 emri, adresa dhe numri fiskal i shfrytëzuesit;</p> <p>1.4 vendi ku është instaluar pajisja;</p> <p>1.5 emrin e operatorit të autorizuar, adresën e tij, numrin fiskal dhe numrin e TVSH-së të personit të autorizuar;</p> <p>1.6 numrin e autorizimit të lëshuar për operatorin, për llojin e caktuar të PEF-it;</p> <p>1.7 të dhënat për personat e autorizuar nga operatori që shesin dhe instalojnë PEF;</p> <p>1.8 personat e autorizuar për të riparuar PEF-ët, ku përfshihet lloji i PEF-it që personi është i autorizuar të riparojë, emrin dhe adresën e tij, numrin identifikues të kartelës, numrin personal identifikues dhe datën e skadimit të autorizimit;</p> <p>1.9 numrin e autorizimit të lëshuar për secilin</p>	<p>number, fiscal memory serial number, CC serial number, manufacturer and FED model and other data required as per technical specifications;</p> <p>1.2 date the device was installed and approved by TAK;</p> <p>1.3 name address, and Fiscal Number of the user;</p> <p>1.4 location where the device is installed;</p> <p>1.5 name of authorised operator, his address, fiscal number and VAT number of the authorised person;</p> <p>1.6 authorisation number issued for the operator for particular type of FED;</p> <p>1.7 data on authorised persons selling and installing FED;</p> <p>1.8 persons authorised to repair FEDs including the type of FED which the person is authorised to repair, his name and address, ID card number, personal ID number, and the expiration date of the authorisation;</p> <p>1.9 authorisation number issued for each</p>	<p>seriski broj fiskalne memorije, serski broj KK, proizvođač i model FEO i ostale podatke opisane u tehicke specifikacije;</p> <p>1.2 Datum kada je instalirana oprema u kada je odobren od PAK-a;</p> <p>1.3 ime, adresa i fiskalni broj korisnika;</p> <p>1.4 mesto gde je instalirana oprema;</p> <p>1.5 ime ovlašćenog operatora, njegovu adresu, fiskalni broj i broj PDV-a ovlašćenog lica;</p> <p>1.6 broj ovlašćenja izdatog od operatora, za određenu vrstu FEO;</p> <p>1.7 podaci za ovlašćena lica od operatora da prodaju i instaliraju FEO;</p> <p>1.8 ovlašćena lica za popravku FEO, gde se uključuje vrsta FEO da je lice ovlašćeno da popravi, njegovo ime i adresu identifikacioni broj kartice, lični identifikacioni broj i datum prestanka važenja ovlašćenja;</p> <p>1.9 broj ovlašćenja izdatog za svaki</p>
---	---	--



<p>PEF specifik.</p> <p>2. ATK-ja, mirëmban dhe freskon bazën e të dhënave për evidencën elektronike.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 17</b> <b>Teknikët e autorizuar</b></p> <p>1. Operatori i autorizuar, emëron teknikët që instalojnë dhe riparojnë PEF-ët, për të cilat është i autorizuar të shesë. Instalimi i PEF-it të autorizuar duhet të bëhet vetëm nga tekniku i caktuar. Operatori i autorizuar mund të kontraktojë persona të tretë që nuk janë të punësuar tek ai për të riparuar PEF-ët. Megjithatë, kjo nuk i heq operatorit përgjegjësinë për të siguruar se riparimi është bërë në mënyrë korrekte dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara.</p> <p>2. Operatori i autorizuar, dorëzon në NjMAF, emrat, adresat dhe numrat identifikues personal të teknikëve, përpara se ata të jenë autorizuar për instalimin dhe riparimin e PEF-ve. Operatori i autorizuar duhet të përfshijë të gjitha të dhënat e nevojshme të kompanisë dhe personale (përfshirë këtu edhe kualifikimin teknik) dhe dokument identifikimi me fotografi.</p>	<p>specific FED;</p> <p>2. TAK shall maintain and update the database on the electronic inventory.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 17</b> <b>Authorised Technicians</b></p> <p>1. An authorised operator appoints technicians who install and repair FEDs for which is licensed to sell. Installation of authorised FEDs must be done by the designated technician. The authorised operator may contact third persons who are not employees to repair FEDs. However, this shall not absolve the operator from the responsibility of ensuring that repairs are done correctly and in accordance with defined procedures.</p> <p>2. The authorised operator must submit the names, addresses, and personal identification numbers of technicians to the FCRMU before they are authorised to install or repair FEDs. The authorised operator must include all necessary company and personal data (including technical qualifications) and a photo Identification Document</p>	<p>specifični FEO.</p> <p>2. PAK održava i osvežava bazu podataka za elektronsku evidenciju.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 17</b> <b>Ovlašćeni tehničari</b></p> <p>1. Ovlašćeni operator, imenuje tehničare da instaliraju i poprave FEO, za koje je ovlašćen da prodaje. Instaliranje ovlašćenog FEO treba da se izvrši samo od određenog tehničara. Ovlašćeni operator može da ugovori treća lica koji nisu zaposleni kod njega da poprave FEO. Ipak, to ne oslobađa operatora od odgovornosti za osiguranje da popravka je izvršena na korektan način i u skladu sa određenim procedurama.</p> <p>2. Ovlašćeni operator, dostavlja pri JUFB, imena, adrese i lične identifikacione brojeve tehničara, pre nego se one ovlaste za instaliranje i popravku FEO. Ovlašćeni operator treba da uključi sve potrebne podatke kompanije i lične podatke (uključujući i tehničku kvalifikaciju) I dokument identifikacije sa fotografijom.</p>
---	---	---

<p>3. NjMAF shqyrton të dhënat e dorëzuara, nga operatori i autorizuar, si dhe mund të kërkojë sqarime të nevojshme, para lëshimit ose refuzimit të autorizimit, për teknikët që do të instalojnë ose riparojnë PEF-ët.</p> <p>4. Pas aprovimit të teknikut, NjMAF do të kërkojë nga njësia përgjegjëse brenda ATK-së, që të sigurojë kartelë identifikuese me fotografi e cila identifikon këtë individ, si teknik për instalim dhe riparim. Tekniku, pajiset me numrin unik identifikues i cili do të krahasohet me numrin identifikues personal të atij/asaj në bazën e të dhënave të mbajtur nga ATK-ja, përshkruar në këtë Udhëzim Administrativ.</p> <p>5. Kartela Identifikuese përmban:</p> <p>5.1. Emrin dhe mbiemrin e teknikut;</p> <p>5.2. Numrin unik identifikues;</p> <p>5.3. Datat deri kur kartela identifikuese është evlefshme.</p> <p>6. Deklaratën se individ i është autorizuar dhe i certifikuar për të instaluar dhe riparuar PEF-in e caktuar;</p>	<p>3. FCRMU shall review the data submitted by the authorised operator and may require necessary explanations prior to issuing, or rejecting the authorisation for technicians to install or repair FEDs.</p> <p>4. Upon approving the technician, the FCRMU will request TAK to provide a picture identification card identifying the individual as a technician for installation and repair. The technician will be equipped with a unique identification number that will be cross-referenced to his/her personal identification number in the data base maintained by TAK described in this Administrative Instruction.</p> <p>5. The identification card must contain:</p> <p>5.1. Technician's name and surname;</p> <p>5.2. Unique identification number;</p> <p>5.3. Identification Card validity date.</p> <p>6. A statement that the individual is authorised and licensed to install and repair designated FEDs;</p>	<p>3. JUFB razmatra dostavljene podatke od Ovlašćenog operatora, kao i može da zahteva potrebna objašnjenja, pre izdavanja ili odbijanja ovlašćenja, za tehničare da instaliraju ili poprave FEO.</p> <p>4. Nakon odobravanja tehničara, JUFB će zahtevati od odgovorne jedinice unutar PAK-a, da obezbedi identifikacionu karticu sa fotografijom koja ga identifikuje kao pojedinca, kao tehničari za instaliranje i popravku. Tehničar se opremi jedinstvenim identifikacionim brojem koji će se uporediti sa njegovim/njenim ličnim identifikacionim brojem na bazi podataka održanim od PAK, opisan ovim Administrativnim Uputstvom.</p> <p>5. Identifikaciona kartica sadrži:</p> <p>5.1. Ime i prezime tehničara;</p> <p>5.2. Jedinstveni identifikacioni broj;</p> <p>5.3. Datume dokle identifikaciona kartica je važeća.</p> <p>6. Izjavu da je pojedinac ovlašćen i certifikovan za instaliranje i popravku određenog FEO;</p>
---	---	---

